

## SHËRBIMI PËR LIGJIN E EMIGRIMIT

Këshillimi në lidhje me ligjin e emigrimit për anëtarët e paprivilegjuar të komunitetit nga ana shoqërore apo financiare mund të aksesohet nëpërmjet Cairns Community Legal Centre Inc (Qendra Ligjore e Komunitetit në Cairns) (Qendra).

Këshillimi për ligjin e emigrimit sigurohet nga Refugee and Immigration Legal Service Inc (RAILS) (Shërbimi Ligjor për Refugjatët dhe Emigracionin) dhe jo nga Qendra. Për më shumë informacion rreth Migration Law Service telefononi RAILS në numrin 3846 3189.

Shënim: Kufizime të rrepta të kohës aplikohen në çështjet e emigracionit. Nëse ju ndikoheni nga kjo telefononi menjëherë në RAILS.

Kjo broshurë është e vlefshme në gjuhë të tjera në faqen tonë të internetit. Broshurat e gjuhëve të ndryshme janë financuar nga Legal Practitioner Interest Trust Accounts Grant Fund.

Informacioni në këtë broshurë është aktual në Tetor të vitit 2006. Mund t'i bëhen ndryshime pa ju lajmëruar.

## A DËSHIRONI TË DINI MË SHUMË?

### Kontakttoni Cairns Community Legal Centre Inc.

#### Adresa:

Level 1  
Main Street Arcade  
85 Lake Street  
(PO Box 7129)  
CAIRNS Q 4870

Në ndërtesë ka hyrje për karrocë invalidi.

#### Telefoni:

(07) 4031 7688 (Shërbimi i Përgjithshëm Ligjor)  
(07) 4031 7358 (për klientat e DDLS në Cairns)  
1800 650 197 (për klientat e DDLS jashtë Cairnsit)  
(07) 4031 7179 (Shërbimi Ligjor për të Moshuarit)

#### Adresa e Internetit:

[www.cclc.org.au](http://www.cclc.org.au)

**I dërgojmë falenderimet tona vullnetarëve bujarë që dhurojnë kohën e tyre për të ndihmuar Cairns Community Legal Centre Inc dhe objektivat e saj.**

**Pa këto njerëz Qendra nuk do të kishte qënë në gjendje për të siguruar shumë nga shërbimet që siguron.**

Këshillim ligjor FALAS,  
shërbime informacioni  
dhe rekomandimi  
të vlefshme në

**CAIRNS  
COMMUNITY  
LEGAL  
CENTRE INC.**

Qendra Ligjore e Komunitetit e  
Cairnsit për anëtarët e komunitetit të  
paprivilegjuar nga ana shoqërore  
ose financiare



## KUSH ËSHTË CAIRNS COMMUNITY LEGAL CENTRE INC?

Cairns Community Legal Centre Inc (the Centre) (Qendra) është një organizatë jo për përfitim e komunitetit.

Qendra drejtohet nga vullnetarë dhe një numër i vogël nëpunësash.

## ÇFARË BËN QENDRA?

Qendra siguron këshillim ligjor FALAS, shërbime informimi dhe rekomandimi për anëtarët e komunitetit të paprivilegjuar nga ana shoqërore apo financiare.

Qendra siguron:

### **(a) Shërbim të Përgjithshëm Ligjor**

Shërbimi i Përgjithshëm Ligjor ofron këshillim ligjor FALAS, informacion dhe rekomandime në fushat e ligjit kriminal, çështjet e trafikut, gjykatën e familjes, aksidentet me automjete, çështjet e borxheve, çështjet e siguracionit, ankesat e konsumatorëve, ligjin e punës, ankesat në lidhje me diskriminimin, çështjet e përfshira të shoqatës, grindjet mes komshinjve, çështjet e falimentimit dhe çështje të tjera ligjore. Shërbimi i Përgjithshëm Ligjor është i vlefshëm për njerëzit që jetojnë ose punojnë në pjesën më Veriore të Kuinslandës (zona në Veri të Cardwell në Torres Strait dhe në Perëndim të Normanton/Karumba).

### **(b) Disability Discrimination Legal Services (DDLS)**

Disability Discrimination Legal Service (DDSL) (Shërbimi Ligjor kundër Diskriminimit në rast Paaftësie Fizike) është një shërbim ligjor i specializuar.

DDLS ofron këshillim ligjor FALAS, informacion dhe rekomandime në lidhje me ankesat për diskriminimin në lidhje me paaftësitë (p.sh. kur njerëzit janë trajtuar ndryshe nga të tjerët për arsye të paaftësisë së tyre).

DDLS është i vlefshëm për njerëzit me paaftësi që jetojnë në Kuinslandën Veriore (zona në veri të Sarinës nga Torres Strait dhe në perëndim të kufirit të Kuinslandës/ Northern Territory).

Në disa raste, shoqëruesit e njerëzve me paaftësi, si p.sh. shokë, partnerë apo kujdestarë, mund të përdorin DDLS gjithashtu.

Për më shumë informacion mbi DDSL drejtohuni tek broshura e posaçme rreth DDSL ose telefononi DDSL.

### **(c) A Seniors Legal Service (Një Shërbim Ligjor për të Moshuarit)**

The Seniors Legal Service është për të moshuarit. Telefononi Qendres nëse keni më shumë pyetje.

## SI TË MARR KESHILLIM LIGJOR?

Këshillimi ligjor bëhet me takim. Takimet janë të vlefshme vetëm në disa orare të caktuara.

Telefononi Qendres nëse keni më shumë pyetje.

## EDUKIMI LIGJOR I KOMUNITETIT

Qendra mban gjithashtu edhe bisedime, punishte dhe seminare për grupet e komunitetit rreth çështjeve të ndryshme ligjore.

Telefononi Qendres nëse keni më shumë pyetje.

## SHËRBIMET E REKOMANDIMIT

Fatkeqësisht Qendra s'mund t'ju ndihmojnë gjithmonë.

Nëse Qendra s'mund t'ju ndihmojnë ne do të bëjmë të pamundurën për t'ju rekomanduar tek një organizatë e përshtatëshme për nevojën tuaj.

## KUSH E FINANCON QENDREN?

Qendra financohet nga Qeveritë e Shtetit dhe e Komonuelthit, pagesat e anëtarësisë dhe dhuratat e publikut.

## A MË DUHET MUA TË PAGUAJ?

Zakonisht shërbimet janë falas. Ndonjëherë mund t'ju duhet të paguani për shpenzimet ekstra ose për kosto të tjera. Nëse ju ndodhë kjo situatë atëherë ne do ta diskutojmë këtë sëbashku.

Dhuratat janë të mirëpritura gjithashtu!

## A MUND TË MARR NJË PËRKTHYES?

Zakonisht (**por jo gjithmonë**) Qendra mund të organizojë që përkthyesit t'ju sigurohen falas.